

VENDIM
Nr.898, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.114, DATË 31.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE QË
VENDOSEN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE TË PËRKUJDESIT
SHOQËROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 23 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, më propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 fjalët “... 50% të pensionit ...” zëvendësohen me “... 40 për qind të pensionit ...”.
2. Në shkronjën “ç”, të pikës 3, fjalët “... në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj ...”.
3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga fondet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të miratuara në buxhetin e vitit 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha